

BIBLIOTEKA

8SH-1

V27



Vargje për dritat

89/1953-1
V 27

5

VARGJE PËR DRITAT

(Vjersha dhe poema)

45520

14367

SHTËPIA E SHTEZËS
GJERGJ KASTRITI

SHTËPIA BOTONJËSE «NAIM FRASHERI»

Tirazhi 2000 kopje Format 70x100/32 Stash: 2204-65

Shtyp N.I.Sh. Shtypshkronjave «MIHAL DURI»
Stabilimenti «8 Nëndori» — Tiranë, 1968

DY FJALE PËR LEXUESIN

Vëllimi poetik «Vargje për dritat» është një përbledhje me krijime tematike aktuale, të botaara në revistat dhe gazetat e përditëshme. Kjo përbledhje përmban kryesisht krijime që shprehin ngazëllimin e përgjithshëm të popullit tonë përvendimin e madh të Partisë, që e gjithë Shqipëria tē ketë dritë deri më 8 Nëndor 1971.

SI TELAT E ÇIFTELISË

Telat po kaptojnë kodra edhe male;
Llampat do ndriçojnë tokën e malsisë,
Malsorit të qeshur që hidhej në valle
I vjen t'i dredhë si tela t'çiftelisë.

Ujrat do rrëshqasin ndër hidrocentrale
Të qeshur, të shpejtë, tërë shkum' e zhurmë,
Me shami ylberesh do hyjnë në valle,
Do bien furishëm, do formojnë lumë.

Dielli ndriçon mbi ujrat e kulluar
e sajon mbi valë pika të shkëlqyeshme
Ndrisin porsi llampa, mbi ujrat shaluar,
Mbi ujra po zbret kjo drita komuniste.

Telat po kaptojnë kodra edhe male;
Llampat do ndriçojnë tokën e malsisë,
Malsorit të qeshur që hidhet në valle
I vjen t'i dredhë si tela t'çiftelisë!

DRITË E RE NDËR MALE

Nji krismë sëpate ndigjohej mëngjezeve të kristaltë
Dhe humbiste thellë n'pishnajën ngarkue me borë,

Akoma pa zbardhë

Dlete malësori prej kullës së lashtë

Për pak dritë,

Për pak zjarr,

Për pak pishë të thatë,

Për kalamajt e unshëm dhe të ngratë

Tue ça të ftohtën borë me gjoks malësori.

N'ato vite,

Kur hala s'kish ardhë Nandori.

Poshtë Valbona rridhte e kaltër, plot shkumë;

Vraponte, dredhonte, përplasej nëpër shkrepë,

Spërkatë brigjet akull

Dhe kanga e saj pafund

Përshkonte thellë ndër lugjet që ka bjeshka.

Kështu dimnit të ashpër...

Dhe kur pranvera,

Malet veshë n'alabastër, niste me i hukatë,

Përsëri grykës së përronit tretesh nji krismë e thatë.

Përsëri Valbona rrëshqiste ashtu plot zhurmë

Me ujnat breg në breg,

Me gjoksin dallgëzor përfshinte lisa të shkulun,

Që i mbërtheheshin në çdo shkrep,

Që s'mund t'ja ndalnin udhën.

... Por ç'ka sot që nxiton plot gëzim postjeri
Dhe nji gazetë të thjeshtë
Si flamur e ngren nalt,
Ndërsa grykave si thikë të pret veri,
Ndërsa kreshtave borë po fijat?
Ç'janë këto shkronja të zakonshme, të zeza,
Që pishën e tymosun po e përzanë nga çdo kullë?
Ç'janë këto shkronja të vogëla,
E të mëdha si shkrepë,
Që po i ndalin Valbonës të pandalshmin vrull?
Që përziejnë tinguj radioje dhe kangë lahute?
— Fjala e Partisë!
Ndaj, ndalni
Ujna mal
Që ndër shekuj shungulluet nëpër thepa!
Duem ne mbi ju
T'shungullojë centrali
Dhe të përcjellë dritën mes pishavë të blerta,
Ku gjimojnë orteqet netëve dimnore,
Ku vrapon pranverës flladi përmes barit,
Ku ndihet kangë e re e muzës s'lashtë malësore
Shpërthyre prej gëzimit të çobanit.
Dhe n'bjeshkët e Namuna
Dritë e re do t'dalë,
Atje ku gëzimi shëtiste vec ndër përralla.
Kohë çalamane!
Shih ç'hap ka Shqipnia:
Marshon shqiptar' i lashtë i primë nga Partia!

MESUESJA E RE

Ajo zbriti
Si drenushë prej malesh
Tue shkelë të lashtin kanun,
Tue shkelë përmbi grumbuj fjalësh,
Që baresnin
Tin'z nëpër katund.

Ajo zbriti...
Me shaminë e bardhë
E mbështolli kryet
Dhe ashtu ballënaltë,
Në sy të botës,
E dogj n'flakën e nji pishtari t'ri.

Ajo zbriti prej fshatit me pisha
Tue shkelë
Livadheve t'blerta,
Ku sa herë dhentë ja trembi bisha
Tok me andrrat
Si flutura të lehta

Ajo zbriti
Që të merrte dritë

E ta derdhte si ar nëpër fshat,
Ndaj atë mbramje
U ndigjuen mbytun
Opingat e trasha në asfalt.

Dhe u këthye
Mësuese e re,
Vajzë-ushtare e nanës Parti
Dhe i jati
Që pati mbushë koburen,
Uli kokën:
— Mirëseardhe, bijë!

UDHËT DO TË ZGJATEN...

Komunistes Shkurte Pal Vata

1.

Ajo ra,
Në sytë e njomë një vizion i moçëm
Nga viset e saj të largëta,
Një vezullim shkëndish prej diellit të soçëm
Në sytë e saj.

Shkurtë,
Ti fabrikave, tarracave, rrugëve të reja...
Në gjirin e ri u bëre vend!
Le të vijnë poetët në gjak të ngjyejnë penat,
Fëmijët të mbledhin lule
Hapësirave të shpirtit tënd.

2.

Ajo ra në hekurudhë mbi trase,
Mbi të dherat u rrëzuan të rënda e të lagura,
Rrjedh në ballë djers' e ngrohtë
Dhe plagët i janë të përgjakura.

Në sytë e pastër si një liqen alpin
(Aksionistët si pemë mbi të varën flokët)
U dukën livadhet dhe borë në Dukagjin,
U pasqyruan shoqet edhe shokët.

Dhe deri tek ata arrinin të mekura
Krismat e gjakmarrjeve nga frëngjité,
Prapa atyre bjeshkëve,
Të trembura e të fshehura
Janë kanunet e lashta, mblesët e priftërinjtë.

Në sytë e Shkurtës.
Si në një burim alpin,
Panë ditën kur u prish çdo fejesë.
Ditën kur s'e mbysnin më rininë
Në liqenin e errët të natës së zezë.

Panë ditën e ardhjes në hekurudhë...
Gjaku i Shkurtës mbi tërë këto ditë binte,
Dhe në shaminë e lidhur në gushë,
Edhe nëpër «S»-të aksioniste.

Shkurtë,
Ku e gjete ti guximin
Për në të përpjetën e zemrave,
Për në të përpjetën e viteve?
Në rënjen tënde dëgjojmë rrapiellimën
E kohrave të përmbyssjeve dhe ngjitjeve.

3.

Dhe ti më fanitesh
Me krahët të zgjatur që nën dhe,
Si dy shina hekuri për në malësi,
Që në trojet e lashta të rendë bot' e re,
Që atit t'i lidhësh tënden shami.

Krahët e tu,
Ndoshta dy shina të mëdha, gjigande,
Më të gjata se bashkë gjithë hekurudhat,
Se ato Katrinat

lidhin me botën e madhe,
Në ballë e në zemrat e etërve fshijnë rrudhat.
Krahët e tu.

Hekurudha për në jug drejtuar,
Ku do rendin karvanet e ditëve të ardhme,
Karvane me djersë e përpjekje ngarkuar,
Me trëndafila e grunja të larme.

4.

Ajo ra,
Na u bë se drejt saj u zgjatën udhët.
Udhë të sambaruara, pa baltë e pluhur,
U zgjatën si duar dhe e morën Shkurtën
Ndër shtigje të reja e të panumurta.

Udhët u zgjatën
Dhe në shtegëtimin e gjatë

Anembanë nga Bistrica në Drin
Ajo si Rozafa e legjendës së lashtë
Çdo vepre në atdhe do t'i falë rininë.

5.

Udhët do të zgjaten
Kohrave dhe shekujve duke shtegëtuar...
Por kur të vijë i ëndërrave komunizmi
Do të ngrihet Shkurta e menduar,
Duke shkundur pluhur heroizmi.

Do të ngrihet,
Në angullimë do i shfaqen viset veriore:
Supat i vë Rozafa baltës së vjeshtës së tretë,
Shkurta do çelë sytë si në një ëndërr mëngjezore,
Do gjendet nëpër këngë të larta sa bjeshkët
Përpjetë.

FILLI ELEKTRIK NË VARGJE

Unë e di, në vargje ende ka dokrra,
Po kur me fill elektriku të lidhen
Kelmendi, Dukagjini, Mokra,
Kush do durojë që vargu të bjerë erë tym kandili?
Dhe dot s'do ta fshehim impotencën poetike,
Ahtere do të themi: «Kështu është shkruar dikur»!
Se vargjet e mbuluar me pluhur
Do t'i zbulojë llampa elektrike.

TË DASHURA VAJZA

Të dashura vajza,
ruhuni nga mblesët!
Mblesët s'dremitin,
mblesët s'flënë;
Skutash e qoshesh ata ngrenë veshët,
Skutash e qoshesh pritë ju zenë.
Në prita shfletojnë me mendje kanunë,
Kafen e pijnë me të liga mendime...
Të dashura vajza,
u hapët punë
Mblesëve të dhjamur,
mblesëve thatimë.
Mblidhen kokë më kokë në kulla
Dhe tundin mjekrat,
dhe tundin qeleshet:
«Dëgjo Shemshedin,
të keqen Dulla,
Erdh' kohë e vështirë
për mblesët»!
Po s'kanë vetëm qeleshe të bardha,
Kanë dhe lidhka¹⁾, dhe borsalina,
Dhe mund të quhen Fredër dhe Arda,
Siç mund të quhen dhe Shemshedina,
Dhe mund të pijnë fërnet «me kulturë»,
Dhe mund të flasin plot delikatesë

1) Lidhkë, kravatë.

Me gjuhë të mengme literature
Dhe prapë të jenë

mblesë..

Të dashura vajza,

ruhuni nga mblesët,

Mblesët e dhjamur,

mblesët thatimë,

Mblesët që ngrejnjë skutave veshët
Dhe skutave tjerrin të zeza mëndime..

KULLAT

Déborë e Dukagjinit që mbush malin
Me thinjë na mbulon si Dukagjinë.
Në apartamente bulevardit «Stalin»
Ne kemi lënë gratë dhe shtëpinë.

Ortiqet uturijnë tatëpjetë,
Si vargjeve të «Mujit e Halilit»,
Thërmohen posa shkuma në përrenjtë
Dhe grykash shket jehonë e tyre e dimrit.

Ne ecim me elektricistin, Pjetër,
Ngarkuar si çetina me dëbcën.
Do shëmbëllinen më rapsodë të vjetër,
Po kemi tela dhe izolatorë.

Ku vemi vallë, ç'duam suferinës,
Pse prishim virgjininë e legjendave,
Që hidhen prej çetinës në çetinë
Dhe natën nanuritin foshnjat djepeve?

Ne shkojmë kullave t'u lidhim tela,
Litarin e kanuneve ta çmpleksim;

45570
1436f

Hej, dukagjinasa e vogël Gjela,
Mos rri pas mureve, ne s'jemi mblesër!

E di, moj Gjelë e vogël, ti, fizikën,
Korent, izolator, ampermetër?...
Afrohu dhe përcille zajesh frikën,
Izolatori izolon dhe mblesët...

Do lidhim mes tavanit të odës tënde
Një llampë elektrike sa një ftua.
Nën llampë le të hidhen mbrëmjes ëndërrat,
Dhe le të ligjerojnë si një krua.

Ne erdhëm me elektriçistin, Pietër,
Që tok të lidhim kullë më kullë tela,
Që vjershat t'i dëgjosh në tela nesër
Me lajmet e gazetës, Gjela!

Furtunë e Dukagjinit e mbush malin,
Dëbora është e ashpër dhe e hidhur.
Na prisni, gra, në bulevardin «Stalin»,
Se kemi shumë tela pér të lidhur.

BALLADE E ASHPER

1

Dajret bien dhe pälçet gérneta,
Sofra nga raki e rrushit laget,
Vajza e xha Agushit me gërshteta,
Ç'ja lëndove djalërisë plagët.
Ç'ndodhi vallë, ku të gjetën mblesët
Javën që të priste Rrogzhina?
A më thuaj, pa një vajzë nesër
Si do ecë rrugëve maqina?
A më thuaj, si do rrish në mushkë
Me duvak mes shtigjeve të liga,
Ndjekur pas nga krushq edhe nga krushka
Nëpër driza, lisa e boriga...

2

Dajret bien, shtrembërohen mjekrat,
Shishja gurgullon, kërcet filxhani
Dhe dasmorëve ç'u shkrihen eshtrat

Nga rakia,
nga farmak — kazani!
Plakat në odën tjetër janë mbledhur,
Dhe kërcet gërshëra në gërshteta!
Shuk në dyshemë t'i kanë hedhur,
Shuk në dyshemë t'i kanë shkelur!

3.

Po për cilin të stolisin
vallë,
Me gërshërë,
me këna
e bojë,
Me të kuq e me «flori» në ballë,
Me këpucë e me fustan të hollë?
Ç'mund të thuash, vajzë e xha Agushit!
Burrin tënd ti kurrë s'e ke parë,
Derdhu sofrës ti raki e rrushit,
Plas në vend gërnetë, plas ti dajre!

4.

Eh, pa ty s'e nisim ne maqirën,
Nuk të lëmë shtigjeve të ligë,
Krushqit do t'i ndalim kur të vijnë
Gërxheve me lisa e boriga...
Edhe unë me të rinjtë e fshatit
Do zë pritë mu në mes të dushqve,
Do të të rrëmbej nga thonjtë e fatit,
Këngën do t'ua lë përgjysmë krushqve.
Vallë, kot rinia jonë rrođhi

Veshur me kapotën partizane,
Djegur nga baruti nëpër llohë,
Grisur nga dyfekë e jatagane?
Vallë, kot plevitin kemi marrë
Udhëve të dimrit në dëborë.
Bukën njëqind copë kemi ndarë,
Plagët operuar me hanxharë?
Vallë, kot anëtarët e Byrosë
Netëve pa gjumë janë thinjur?
Ne s'e lëmë shpirtin të ja tymosë
Vajzës nëpër oda jetë e hidhur!

5.

Bini dajres, çajeni gënetën,
Derdhini filxhanit raki rrushi!
Prejani e hidhjani gërshetën
Vajzës së parritur të Agushit!
Pse u ngryse, xha Agush, në sofër?
Pse s'iu ndodhe çupës tënde pranë?
Ne e dimë, ti i vije odës
Zjarin, kur na prisje partizanë,
Rrotull këtij muri varnim pushkët,
Rrotull kësaj vatre ndjenim shqotën,
Rrotull kësaj sofre hanim bukën
Dhe mendonim ta ndryshonim botën.
Bota qenka kockë e vështirë,
S'u ndryshuaka lehtë, xha Agush!
C'ja ke ngulur sytë e tu të mirë
Vatrës mbushur plot me dru e prush?
Prushi tretet,

prushi bëhet hi,
Lëre prushin dhe vështro tët bijë,
Ç'i punojnë plakat me magji,
Se në sytë e saj ka një shkëndijë.
Po shkëndija s'shuhet, xha Agush,
Se e kemi ndezur me mundim.
Në mullar të thatë po ra prush,
Do të ngrihet flaka me tërbim...
Më vjen keq të shkruaj këto vargje,
Vargje me mërzi e dhëmbje thurur!
Xha Agush, i ngrysur me mustaqe,
Ti në vjersha duhej t'ishe mburrur.
Po ti mbahesh prapë në botën tënde,
Botën s'do ta prishësh,

s'do ta ndërrosh!
Shumë pas oxhakut vrave mëndjen,
Prapë me botën tënde do të rrrosh...
Vallë, kot i ndalëm ne lumenjtë
Dhe i shtrydhëm valët nëpër llampa.
Me oxhak betoni shpuam qiejtë,
Edhe varfërinë e lamë prapa?

6.

Mbushi odën mjegulla e rakisë,
Sazexhiut të shkretë i mpihen buzët...
C'e zhub'os fustanë e nusërisë,
Vajza më e bukur e Agushit?
Era bredh në gryka e rrëpira,
Këngët tona tok me erën ziejnë,
Krushqit pranë sofrës janë pire.
Krushqit herë zgjohen e herë flenë.
Ne e dimë, s'mund të rrish në kullë,

Kënga jonë hyn nëpër dritaret,
Të thërret të vish në hekurudhë,
Të thërret sirena në binaret.
Hesht ti dajre, hesht dhe ti gërnetë,
Derdhu mjekrave, raki e rrushit,
Rrotull mos u sill, dolli e nxehtë:
Eshtë jona çupë e xha Agushit...

PËR KU PO SHKOJNË KËTO DELE?

Në fillim të pranverës kooperativa e Tragjasit, në shenjë miqësie dhe solidariteti, do t'i dërgojë Pecajt pesqind dele dhe dy mushka.

Kumbimi i zileve në agime
troket mbi dritaren tonë,
për ku po shkojnë këto dele
porsi një grumbull me dasmorë?...

Para i pret veriu i bardhë,
buçet nga pas Joniku i kaltër,
blegërimat zgjaten tutje
mbi katund të Shkurte Vatës.
Përmbi çatira rrodhën hapësira,
dëborë e ftohtë shkriu në male.
Pranvera vjen
nëpër livadhe
e bardhë si një tufë me dele.

Barinjtë lëvizin shkopinjtë në erë
të lodhur
rrugëve të gjata...
Po kur dëgjon zile e këmborë,
del te pragu Zojë Vata.

Del...
edhe dëgjon se si
vjen nga larg një këng' e shtruar labe.
— O patëm dy vajza, dy gjeraqina,
që u këputën si dy lule.

Patëm dy çika si fëllanxa mali,
dhe lindi kjo miqësi e re.
— Për ku po shkon ky varg me dele
me blegërima rrugëve?...

BJERUNI BURIVE!

Kushtuar Shkurte Pal Vatës

Jeta jote, nuk besova Shkurtë,
 t'ishte kaq e shkurtër, kaq e thjeshtë
 Dhe të pesëmbëdhjetë pranverat e tua
 unë t'i mblidhja sot në këtë vjershë.

Lulet e kurorave ende s'janë tharë,
 kemi kaqë net pa qetësi.
 O, ti ike si një zogth i bardhë,
 fluturove në përjetësi.

Fluturove...
 dhe mbi këngë re
 duke dalë nga gjiri i aksionit,
 edhe kënga ime më e rë
 u spërkat me gjak revolucioni.

Po buritë bien përsëri,
 në marshime na thërrasin prapë.
 Doli ati, burri, malësori:
 — Sillni shall'n e saj ta lidh në qafë!

Bjeruni burive për marshime!
 Shkurta ime ja... u ngrit sot prapë».
 Dhe buçiti kënga e gëzuar.
 dhe flamurët u ngritën më lart.

NËN LINJAT E REJA ELEKTRIKE

Linjat e gjata rendin
Si vargan i largët zogjsh nën retë e maleve.
Vargan gazmori ngarkue me drita dhe kangë.

Po eci nën këtë shtegëtim të gëzuem telash.
Nën fluturimin e rapsodive që rendin në muzg.
Dëbora bie...
Toka dhe qielli mbështjellë me lumtuni të bardhë

Mbramja po zbret mbi pyjet dhe udhët,
Mbi sinqeritetin e dëborës — natë.
Mirëmbrama male!
Sonte çdo shtëpi asht një agim i vogël.

FSHATI ZBARDH...

Fshati zbardh majë malit, mes pyjesh,
Si brilant mes së gjelbrës kurorë;
Verës ai ndrin nën dritëra yjesh,
Dimrit ndrin nën reflekse dëbore.

Janë të reja shtëpit', orenditë,
Dhe ndërgjegjet, mendimet e zemrat...
Mes së resë, kandilët, të mpitë,
Ngjajnë si monstër, mes foshnjesh të ëmbla.

Përmbi fshatin në mal, në çdo skutë
Po montojnë telat tona elektrike,
Dhe gjithë fshati ngjan kështu si lahutë
Që këndon kohën tonë heroike!

TE SHKRIHEM ME NJEREZIT

Hyra në vathë dhe delet u trembën,
Dhe rrëzën e gardhit zunë.
Mua, bir fshatari, më theri në zemër
Që delet të tremben nga unë.

Për punë fizike nga shkolla vij,
Të hapim këtu tarraca zabeleve,
Dhe desha të shkrihem me njerezit e mi,
Deshë të çmallem me delet.

Po delet s'më njohën, as sytë s'm'i hodhën.
Dhe shtyhen të gjitha anëve.
S'e dinë ato të shkreta, që unë
Kam lindur në mes të çobanëve.

Në djep kur qaja që m'ikte nëna,
(Të shkretat nëna ngarkuar!),
Delet ngrinin kokën nga hëna
Dhe bleqerinin për mua.

Dhe, kur me to në pllaj' e rrëpira,
Lozja me fyell në dorë,
Tundnin kokën delet e mira
Dhe binin e binin zile, këmborë.

Ndaj mos më shihni, dele, shtrembër,
Unë erdha dhe juve t'ju shtie ca bar,
Se mua, shpeshherë më dridhet në zemër
Blegërima juaj e bardhë.

KJO ASHT SHQIPNIA

Fragment poeme

Pasunia dhe historia jone
Janë ditët tonë,
Kur mëngjezi i pastër
Po shpérndan errësinën e shekujve
Të mbetun në cepat e ndërgjegjes sonë,
Kur po ngre mburojë kundër hijeve
Që po lëvizin tinxare,
Kur po shuen thirrjet e zbeta
Të së kaluemes gjakatare.

* * *

Në male gjithmonë kanë shkrepë rrufetë,
Dhe huta,
Dhe sytë e zemëruem
Në urrejtje për anmikun.
Malet do të shkrepëtijnë
Pas stuhisë së shekujve
Tani me elektrikun.
Peisazhin e njimijë idhive dhe nji trimnie
Në vëllavrasje e mbyllun në zi,

Grykën e pushkës në parzmën e mikut-vëlla
Gjithmonë të nxitun, përsëri të nxitun,
Do ta zhdukin me mijë drita
Në peisazhin e njimijë trimnive pa asnji idhti.
E ç'dritë mund t'i ipte atëherë

Nji shekull Shqipnisë
Në mes të njimijë idhtive!
Shqipnia, që pat qenë n'Evropë pa dritë,
Do të ndriçojë si nji anije dritash.

D R I T E

Brinjét malësisë i pat'kafshuar
terri i netëve të acarta...
Nga drita hijet janë tmerruar,
tek ngjitet bjeshkëve të larta.

Do të fryjnë erërat e maleve
nëpër telat-artere të malësisë,
e si me një lahutë vigane
lavdinë do t'i këndojnë Partisë.

TELAT E LUMTURISË

Për në malësi zgjaten tela lumturie,
Agime të bardha zgjaten për në malësi.
Harku i hënës tela ve u bie,
Gjëmon daullja me timbër të ri.

Gjëmo daulle! Tarracave poshtë,
Mbi çadrat vullnetare oshëti!
Këtë natë mbi vello déborë
Llampat po rrjedhin flori.

Kurrë mos pusho, gjëmo daulle!
Katarakt rrridh në llampë!..
Komunizmi ngjit hidrocentrale,
Shaluar ujvarave, me vrap.

NE KETO DITE DHJETORI

Fragmente

«Pak dritë, pak dritë...»
Ç'është ky zë i thellë,
Kush e ka humbur rrugën buzë ndonji honi?
Është Migjeni,
Kërkon një pishë, vërtitet,
Hapat e tij gjëmojnë poshtë gropave të poemave.

Pak dritë,
Po dritë s'ka;
Nata rëndon
Mbi udhët, tjegullat e pullazit, mbi fatet,
Mbi mërzinë e vajzërisë, plazhet, klithmën e gjaksit.
Mbi këngën bulkthit, vetminë e poetit.

Gjeografia ekonomike.
Shqipëria. Tabelë.
Kaq grurë, kaq dele, kaq hekur-nikel.
Sa ishte energjia elektrike për frymë?
Ah, mbylle librin dhe hap më mirë dhimbjen!

Ashtu siç hanim një herë mish në vit
Në dasmë apo në zi,
Ashtu e merrnim

Gjithë dozën e elektricitetit të vitit, befas,
Në formën e një rrufeje vdekjeje.
Ky gjëmim i shkurtër,
Kjo dritë e bardhë,
I vetmi elektricitet mbi kaptinën shqiptare.

Përse gjëmon daullja,
~~C'valle e re~~
Mbi vallet e moçme dridhet e furishme?
C'lajm dha partia?
Komunikatë e shkurtër;
Vallja vigane e elektroneve.

Në kioskat e bulevardeve, në bufetë e udhëve
dimërore,
(Ku shoferët te banaku kthejnë një fërnet për t'u
nxehur)
Në oborret e uzinave, te zyra e shefit, në koridoret
E spitaleve, mbi spondet e kamionave, te sheshi
Përpara sporteve të theatrove, në kafe, në vend-
qëndrimet
E autobusave, te kabina e policit përpara amba-
sadës,
Kudo, kudo, kudo
Në duart e njerëzve faqet e «Zërit të Popullit»
Kërcasin si të gjalla:
Do të bëhet dritë.

Erë e ftohtë të pret. Dhjetor. Dimër.
Mbi ballin e njerëzve lexohet «Dibër»

Ecin drejt veriut autokolonat pambarim.
Tek dyert e Dibrës trokasin krahinat,
Trokasin qytetet.
«O i zoti i shtëpisë!»

Mbi maqinat trarë, këngë, çadra,
Dialogje të shkurtëra, cimento, dialekt tjeter,
Vajza me pantallona, inxhinierë që grinden
Për kalkulimet.

A e ndjen erën e limonave?
Pejsazhi jugor ka ardhur mysafir,
Si një kuvertë shtrohen mbi supet e ngrira të veriut
Ullinjtë, bagëtitë e lebërve (zilet, era e staneve),
Në sfondin e kamionit një këngë labçë,
Që era ja gris fjalët përtej tek gryka.

Këtu, mbi gërmadhat e bardha mbi tërmelin.
Bie lajmi i madh,
Do të bëhet dritë.

Ujrat hidhen në male si dhitë e egra,
Ne do t'i ndjekim pas,
Do t'i zémë përmes shkrepave,
Ujrat bien rob në qafat e maleve,
Dhe sajohen mjekrat e hidrocentraleve

Në pjerrësitë e digave shkumë e bardhë
Stërkala, ylbere, lëvizin, rrëshqasin

Përmes dritës komuniste, mbi betonin e digës
Derdhet mjekra vigane, e përjetshme e Marksit.

Kur muzgu t'afrohet, kur mbrëmja të bjerë,
Dhjetra mijëra çelësa do të hapen rrresht.
Dhjetra mijëra çelësa dö të shkrepin: trak, trak
(Sic shkrepën në luftra pushkët me çark.)

Hap një çelës: godit fanatizmin në brinjë,
Hap një tjetër: bjeri fesë, (u trullos!)
Hap të tretin: kanuni u zbeh, (verboje!)
Hap të katërtin, të pestin, të dhjetëmijëtin. Trak.

Dhe do të shfaqen kudo majë shtyllave të larta
Grumbuj, grumbuj si zogj
Izolatorët e bardhë,
Zogj, që nga stina e komunizmit na kanë ardhur.

Kështu na vijnë nga largësitë e kohës
Konceptet, ngjyrat, tingujt e komunizmit,
Duke çarë mes për mes kaosit të errët
Të botës së vjetër;
Duke çarë barikadat
E tmerrshme të pronës, interesit, egoizmit,
Duke shkelur grumbuj burokratësh, karieristësh,
Fanatikësh, indiferentësh, pesimistësh.
Vijnë,
Dhe herë ndalojnë majë një shtylle, herë majë një tjetre,
Si këta izolatorë të bardhë, të bardhë.

Llampat do të ndizen nëpër qoshet, skutat,
Mbi bodrumet dhe koridoret e errëta të së shkuarës,
Tek humnera me lugetër dhe magji të çuditshme,
Tek kryqëzimi i udhës, ku u rrëmbye një vajzë,
(Çarçafi fërgëllonte mbi të si shkumë e zezë)
Tek udha e braktisur, tek pusia ku një natë tectori
Gjëmoi klithma tragjike: «ah, më preve në besë!»

Llampat mbi kokat e thinjura, mbi tokën e vjetër,
Mbi konturet e saj të shtrembëruara nga dhimbjet
E tmerrshme të lindjes
(Shumë të vështirë
E ka patur kjo tokë të lindë jetën njerëzore.)

Dhe bijtë e saj e dinin këtë gjë,
Ndaj për të mbrojtur këto konture të shtrembëra
(C'na kujtojnë gjymtyrët e nënave tona!)
Binin shpesh përmbyss aty-këtu nëpër brinja,
Vesë në flokë, ca thërrime në xhep, në gjoks ca
vrima.

Llampa mbi tokën tonë të bukur...
Në çdo llampë do të ndizet fytyrë e Shkurtes,
(E bardhë siç e pamë për herë të fundit)
Në çdo llampë do të fiket fytyrë e Shkurtes,
(Nata do të kërkojë të drejtat e saj mbi të).
Por më kot. Çdo natë mbi kokat tona,
Nga kaosi i errësirës, ajo do të na vijë
E thjeshtë, pak e drojtur do të na thotë «mirë-
mbrama».

C'ishte kjo? Ministre? Inxhiniere?
Do të pyesë ndoshta

Në leksion ndonjë nga nipat tanë
Ç'metodë përdori, ç'kalkulime, ç'mjete
Për të shpejtuar elektrifikimin në malet e larta?

Ajo s'ish inxhiniere, as zyrtare e lartë.
Ajo ishte një vajzë e vogël e partisë
Me një vdekje të shkurtër,
Me një jetë të gjatë.

Do të bëhet dritë,
S'është bibla që flet,
Është partia. Zëri i saj si gjëmimi
Kalon përmes zemrave të popullit si përmes repro-
duktorove,
Rritet e rritet gjithnjë,
(Ç'jehonë madhështore!)

Kurrë s'do ta ngrëmë kryqin e drurtë të biblës
Drejt Golgothasë.
Në brigje dhe male
Do të sulemi të gjithë, duke mbajtur në duar,
Mijëra shtylla centrifugale.

(Dhe kur të shkojë malësor i vogël në teatër,
Kur të shohë pjesët e zymta të Shekspirit,
Do të thotë më vete:
Natyrisht kaq intriga
Të frikshme e të errëta ka patur në mesjetë,
Gjersa s'kishte hidrocentrale
Dhe elektricitet!)

Mbi pejsazhin e shtrirë ca tela të holla
Do të vrapojnë, siç vrapon në luftë pararoja,
Prapa telave do të sulen radiot, prizat,
Muzika, lajmet, shqetësimi i botës,
Antenat, hekurat elektrikë, kuzhinat,
Sobat, ventilatorët, çarçafët e bardhë
Të larë e të hekuosur (me një erë të quditshme
dielli)

Mbrëmje dhjetori. Kalimtarë. Dimër.
Në sytë — llampa. Në ballë — «Dibër»

Në Boulevard të madh, tek Rruga e Dibrës, në
trotuaret
Vështroj si ecin me shpjetësi kalimtarët,
Njerëz me kapele, pa kapele, me pardesy, me pallto
të madhe.
Vajza të bukura, vajza të zakonshme, pensionistë,
ushtarë,
Djem më pulovra, zëvendësministra, më radhë
Kalojnë njerëzit. Them vetë:
Ja këta janë shqiptarët.

Si rrjedhin ujrat në vijat e arave,
Ashtu rrjedhin papushim në rrudhat e tyre
Jufrat, tërmëtet, gëzimet, alarmet,
Fijet e dritës, transhetë, tarracat,
(Llogore e përbashkët jep rrudha të përbashkëta).

Mbrëmje dhjetori. Rrugë. Dimër.
Në sytë — llampa. Në ballë — «Dibër».

Dhjetor 1967.

ELEKTRIFIKIMI

Nga të gjitha mbrëmjet, kjo mbrëmje
E jashtëzakonshme
zbret mbi Shqipëri.

Me një pishë në dorë,
si me sépatë,
Fisi im mundohej të çante natën.
Kurse nata na hynte
Në sy, në trup, në rroba, në këngë.

Kur vdiste njeri,
Fisi im thosh:
— I ndrittë shpirti!
Vetëm pas vdekjes — ëndërronim
Se mund të kishim dritë...

Eh, sa malësorë dolën nga nata
E shkuan prapë te nata!

Nga të gjitha netët — kjo natë
E jashtëzakonshme zbret në Malësi.

Futem në dhomë
Dhe me një çelës — zgres një diell,
Përmbyss errësirën
E shekujve që shkuan.

SI NJË YLBER I MADH

Nëpër tufane do të shkunden malet,
Do të hedhin poshtë vështrimin shekullor,
Dhe do të shohin përmes dritash fshatrat
Si këng' të kuqe shkruar mbi dëborë.

Netët e bardha krejt do të magjepsen
Nër melodira që s'i pan' përmot.
Jo, të till' gëzim njerëzit e bjeshkëve
As në përralla nuk e shpikën dot!

Flokët e borës si ar do të ndrijnë,
Kur do të çirret dimri plot dumani,
Gëzimi do të ndizet përmes erërash
Si një ylber i madh nëpër tufan.

Netët e thella plot me këng'e yje
Nëpër malësi do të shfaqen krej të kuqe,
Që nga dritaret e shtëpive dritat
Do të bien mbi dëborë si lulekuqe.

O ti malësi e netëve të kaltra,
Me çifteli gëzimin po e thua,

Merr nga një llampë netëve të bardha,
Edhe ndriçoi legjendat e tua!

Dhe kur të bjerë larg mjegull e dendur,
Të varen retë bjeshkëve si përrenj,
Do shohësh si nga këngët i akcionit,
Shkurte Pal Vatën që e qeshur vjen.

Në bukurinë e syvë fëminorë
Do dallgëzojnë dritat kënd më kënd,
Si lule të bardha nëpër duar
Do të mbajë flamurin e gëzimin tënd...

Telat si rrugë pa kufi do të zgjaten
Nëpër Atdhe, kjo ditë si këngë do mplekset,
Dhe bukurin' e netëve të reja
Do ta lulëzojnë mbi dëbor' reflekset.

Ti qesh me zjarr malësi e përtërirë,
O nën' që lind gjithnjë heronj të rinj;
Hej, bjeri çiftelisë ti vajzë e bukur,
Për këngën e Partisë, mbi shkëmbinj!

KËNGË E RE

Lamë prapa
Duvakun që mbulonte ëndërrat,
Gjerdhet dhe muret
Që shtypnin shpirtin e etur për fluturim,
Lotët e gëlltitura në heshtje.
Qëndizmat pambarim.

Lamë prapa...
Dhe dolëm në ditë të reja.
Nuk duam më të rrimë të strukura
Në një kënd të plogët mërzie.
Tonat janë rrugët e pafund të Atdheut,
Kantieret.

Fushat,
Uzinat nën diell.
Tonat janë dhe ditët,
Që ende nuk janë.
I ndajmë tok gjëzimet,
Dhe zemrën tok e ndajmë.
Në shpirt na vërsxon vrulli i ditëve,
Me gjak të zemrës sonë do t'ujisim
Lulet e s'ardhmes sonë të bukur.

B U K A

Ishin ulur fshatarët
në qafë të malit
Me shpatulla mbështetur
mbi prush të perëndimit,
Pinin cigare «Partizani»,
Flisnin për bukën,
Flisnin për dimrin.
Në zemrën e tyre ish vrarë mosbesimi
Për gurët, për shkrepat
që s'pillnin asgjë.
Po ata e shtynë në greminë mosbesimin:
«Do bëhet, mor vëlla që ç'ke me të!»

Donte mali gugatje pullumbash,
Ortiqe dëbore, në dukje, donte,
Po në zemër dëshira e ndezur e bukës
Bri këngës së lashtë të pushkës jetonte.

Bri trimnisë, si bashkëshore,
Shtigje kërkonte kënga e bukës.
Si tufë me yje të vezullonte
Tufa e grurit
Në tytën e pushkës.

U ngrit besimi përmbi shterpësinë.
U varën fshatarët tatëpjetë shkrepit.
Mbas teħut tē kazmës vërenin begatinë.
Si dikur fitoren mbi armiqtë, mbas thepit.

Kështu, or vellezër,
Zuri fill një legjendë
Me heronj të vërtetë të kohës moderne.
Atëherë pasqë:

Përbri trimërisë
Urtia e madhe e popullit shkëlqente.
Dhe mbiu buka
Mbi brinjë të maleve...

Po ngjitet socializmi i ndritshëm përherë,
Gjer ku s'harriti fantazia dikur;
Dhe shembet mosbesimi në humnerë,
«Do bëhet mor vëlla, që ç'ke me të!

PRANË NJERËZVE

Kam shkruar për hapësirat e vezulluara nga rrezet
Për diellin pranveror, për lulet
Dhe bimët,
Për netët vjeshtake plot fillade të freskëta,
Për dëborën e belluztë
Për erërat dhe stinët.
Më ka prekur në shpirt kaq thellë natyra,
Relievi i Shqipërisë i gjelbëruar
Me pyje,
Thëllëza e fushës dhe dreri
Dhe ajri i kulluar nën halëza pishe.
Por, a mund që të shpreh me ëmbëlsi poetike
Tërë dashurinë që kam
Unë për tokën
Duke folur vetëm për bukurinë ekzotike,
Për ylberët dhe perëndimet,
Për lisat dhe shqatën?
Por unë s'jam i verbër të mos shoh
Krahas luleve,
Krahas krahëve të fluturave dhe xixëllonjave të
 arta
Si ngrihen gjigande me shkëndijat e furrave
Oxhakët e uzinave tonë
Dhe furrënaltat.

Por unë s'jam i shurdhër të mos ndjej kur agon
Zhurmërimin e kantiereve të punës,
Sirenat,
Karvanet e drithit dhe maqinat me krom
Krahas zogjve dhe pyjeve
Që i flladitin pranverat.
Ndaj më duhet gjithmonë pranë njerëzve
Të rri,
Pranë tokës dhe jetës
Që në thellësira të futem,
Pranë hallevë të popullit dhe gëzimeve të tij,
Un' bir i tij që me nderim
I përulem.

JEHONA E DHJETORIT

Fragmente

Në mëngjezin e borës së parë
m'u duk sikur u zgjova në lashtësi
dhe e ndjeva veten kaq të thinjun dhe kaq të ri.
... Dhe binte e binte borë...
dhe vështrimi im kulloste i dehun
dhe i pikëzuem mbi një mbishkrim gjigand në kodrën
krejt të thinjun bore...

«Lavdi P.P.SH.»
Dhe binte e binte borë.
Me duert e mia të mëdha që s'm'i zanë xhepat
numroj diçka nëpër terr.
Numroj...
E ç'mund të numrosh me dhetë gishtat?!
A mund të numrohen sa pullaze lumtunije
Kanë ngritë këto duar në ato ditë dhjetori?
A mund?...

Brigjeve të detit ngjaj si shtegtar i harruem.
Në kokë, shumë mendime
e në zemër kaq lumtuni.

Dhe sa e bukur kjo natë!

Hana, e shpuemja hanë prej kryqeve e minareve që ngriheshin mbi kryet tonë si fantazma të smueme, si kobe të pushtimeve anmike,

e hoqi duvakun, gjumi sytë ja perëndoi.

E unë mesnatës eci brigjeve.

Unë, kalorësi që munda tërmelin...

Në këto ditë të randa të këtij viti

na u desh të luftojmë edhe me anmikun natyrë.

Urithi i tokës keq e kafshoi lindjen e trollit tonë.

Keq...

Duhej...

O sa shumë duhej!...

Dhe s'kish kohë me mendue gjatë

sepse dhjetori të shtinte të ftohtit kërcnues

në plagët e gjymtyrëve tona,

e plagët duheshin lidhë.

Duheshin...

Ky anmik i paftuem duhej varrosë.

Dhe kaq afër u gjetjeta pranë vdekjes

dhe kaq shumë jehuen daullet,

rranxë Korabit,

sa tingllima e tyne do të ndihet

si pushkatim i çdo të papritune

i çdo mësymjeje anmiqësore

edhe ndër breznitë që do të vijnë.

Nga thellësitë e dheut buçiti kambana e kushtrimit

«Ndihmë Dibrës!»

Dhe si lisa malë mbinë njerëzit

nëga të gjitha anët e atdheut.

Dhe zija u këthye në festë

Dhe vaji në kangë
Dhe çdo kush qe ma shumë se shok
Dhe çdo kush qe ma shumë se hero.
Mbi çdo rrrenojë nji shtëpi e re,
Mbi çdo shtëpi një flamur fitoreje.
Te çdo njeri: buzëqeshje
mbi çdo ballë: krenari.

Autokollona të panumërt
rrëshqisnin çdo ditë dhe çdo natë në rrugët e akullta
malore
e dritat përziheshin netëve me uturimën e motorëve
sa dukej se talleshin me ftohtësinë e yjëve të zbehtë
dhe ngjanin tërthoreve malore
sikur shkelnin mbi vija zjarri,
sikur lëshonin vija zjarri prej rrotave të mbrame
për duert e mërdhime të punëtorëve
që bërtitnin: «ma shpejt! ma shpejt!»

Këndej dhe andej dy botë të kundërtat.
Dhe ndonëse nji piramidë na ndan
edhe gëzimin, edhe idhnimin e kemi të përbashkët,
Në të dy anët tërmët,
në të dy anët i njëjti tmerr kaploj.
Dy botë...
dhe kaq i thellë u duk hendeku i ndamjes
dhe kaq afër ndihej krratja e korbave
që silleshin mbi kryet e njerëzve,
kaq shurdhët ndëgjoheshin tam-tamet
e daulleve të ramazanit
e pëllitja e hoxhëve nëpër minare
sa edhe besimtarët këthenin shpinën,

dhe t  k thyem dyfish prej t  ftohtit,
sh ndrrroheshin n  pik pyetje pasigurie.
Dhe e tmerruemja, e braktisuna Dib r
q endronte var  n'at  shpat mali
Si fener i shuem.

* * *

Andej dhe k ndeje...

K eto dit ...

Si mund t'i harroj k eto dit ,

Si mund t  hesht p r k eto dit ,

Kur lemerija e f mij ve n  mes tren ve t  çaprapikuna

e kulmeve t  rr zueme

ngrihej si re t merri mbi kryet e njer zve

dhe njer zit ngjanin me fantazmat e tyne

dhe kaq shum  i sh mbllenin braktisjes

sa v zhguesit do t'i dukej

se po sheh n  ekran kopet  e para njer zore
kah flijohen p rpara p rbind shave t  natyr s.

O c'tallje! C'ironi shovene!...

C'predikim n n shtrimi ndaj forcave t  natyr s!

Dhe dit  p r dit  pamje t  tilla dalin n p r ekranet
e televizionit

si ngushllim p r «fatalitetin hyjnor»

q  dikush duhej flijue...

Dit  p r dit ...

Dhe kaq shum 

trumbetojn  t  vetmin shp tim: braktisjen e Dibr s
Kaq shum ...

O c'r ac  e pabindun!

Si nuk duen ta meritojn  k t  kujdes t  fabrikuem?

Edhe kur fëmijtë s'kanë ç'të ndukin
në gjiftë e shterruna
në gjiftë e akullta,
pijnë në sytë e nanave kangën e dashunisë
për trollin që asht mishnim i vitalitetit të tyne.
Dhe kaq pranë e kanë vdekjen
dhe kaq larg i rrinë!...
Dhe këndej oxhaqet e reja ngrejnë kangën e pa-
mposhtjes,
ndërsa ata hukatin kangën titanike të qëndresës:
Dhe ky dhe,
dhe këta trenë,
dhe këta gurë
janë kaq të shtrenjtë për ta.

E lashë kangën e solidaritetit në Dibër
dhe nisa prap rendjen tërthoreve malore
me vete mora vetëm lumtuninë
e atyne njerëzve

Vrapoj...
S'kam as kohë t'ju përshëndes,
Dhe majëmaleve sytë e xixëllojave
filluen të lëshojnë shkëndijat e ndriçimit
sepse jeta kudo duhet ndriçue,
sepse kanga ma e bukur
asht kanga që s'e ke ndigjue.
Kanga që s'e ke këndue...
Prandaj duhet nxitue kaq shumë.
Prandaj...

Nga të gjitha anët: «Alo!»
Nga të gjitha anët: «shoko!»
Ngado më thërrasin
dhe kudo duhet shkue,
sepse thirrjes me thirrje i duhet përgjegjë
Alo!...
Po. Do të vij...
Dhe do të vij para se ti të më presësh...
Heshtje...
Shoko!

Sa e kandëshme kjo heshtje mbas lodhjes,
kur në eterin e vrullshëm
thith çlodhjen e fjalës «Shoko!...»

... Dhe binte e binte borë...
Dhe çuditrisht në këtë mëngjez dimëri
vetëm mbishkrimi: «Lavdi PPSH»!
që zbardh në kodra
si simbol i lavdisë së këtij dheu.

PELETEKA E SHETER
SEREQASE FEC

PASQYRA E LENDES

Si telat e çiftelisë K. Dhamo	5
Dritë e re ndër male M. Elezi	6
Mësuesja e re M. Elezi	8
Udhët do të zgjaten S. Bejkö	10
Filli elektrik në vargje D. Agolli	14
Të dashura vajza D. Agolli	15
Kullat D. Agolli	17
Balladë e ashpër D. Agolli	19
Për ku po shkojnë, këto dele? S. Mato	24
Bjeruni burive! S. Mato	26
Nën linjat e reja elektrike F. Reshpja	27
Fshati zbardh A. Mamaqi	28
Të shkrihem me njerëzit A. Shehu	29
Kjo asht Shqipnia A. Gjakova	31
Dritë M. Xhaxhiu	33
Telat e lumturisë R. Gjoza	34
Në këto ditë dhjetori I. Kadare	35
Elektrifikimi K. Blushi	42
Si një ylber i madh Ll. Nano	43
Këngë e re K. Kodra	45
Buka Xh. Spahiu	46
Pranë njerëzve M. Zego	48
Jehona e dhjetorit A. Istrefi	50